

SHTOJCË
Në Dokumentat Standarte të Ankandit me objekt:
“Shitje nafte brut, sasia 158 201 ton”

Autoriteti Shitës Albpetrol sha bazuar në Urdhërin nr.83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produktit hidrokarbur” i ndryshuar”, pika 11, dhe pas shqyrtimit të ankesës mbi DSA-të e këtij ankandi, vendosi të hartojë këtë shtojcë me përmbajtje si më poshtë:

1. Në Shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të këtij ankandi, “Kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vleresim te ofertes”, në rubrikën “SHËNIM” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës se Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë ne Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Bëhet:

Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës se Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë ne Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet me të cilët Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe sipas të cilave këto vende janë të përjashtuara nga detyrimi i legalizimit apo apostilimit paraprak të dokumentave. Në rastin kur dokumentat do të jenë lëshuar në një nga këto vende me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje reciproke atëherë dokumentat e paraqitur prej operatorëve ekonomikë në këtë ankand do të konsiderohen të vlefshme pa formalitete të tjera, mjafton që ato të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

2. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Ishte: datë 20/ 01/ 2021 ora 11:00.

Bëhet: **datë 27/ 01/ 2021 ora 11:00.**